

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA IN ISRAJA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia.org Org. Unit	SP-02	Nr i Prot. Broj Prot.	3619-2/24
Nr i Faqeve Br. Stranica No. Pages	04	Data: Date:	12.11.24
PRISHTINË / A			Nr. 1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.10.2024
REFERENC-Ë:	24/3619/ MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Gratis Commerce" Sh.p.k. Qendër grumbulluese e metaleve mbeturinë, Mitrovicë.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Afrim Murati, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, "Gratis Commerce" Sh.p.k. nr. prot. 24/3619/MMPHI, për veprimtarinë: Qendër grumbulluese e metaleve mbeturinë, Mitrovicë

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

1. Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin, "Gratis Commerce" Sh.p.k., Qendër grumbulluese e metaleve mbeturinë, Mitrovicë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/3619/MMPHI
Datë: 20.09.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori, "Gratis Commerce" Sh.p.k., Mitrovicë, **pajiset me Leje Mjedisore** për veprimtarinë: Qendër grumbulluese metaleve mbeturinë, ngastrën, nr. P-71208 072-02670-1zona kadastarle, Mitrovicë.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë mbikëqyrjen në vazhdim të sistemit të mbeturinave metalike në platotë e sipërfaqes operuese;
 - 2.2. Në mënyrë të rregullt të mirëmbahen dhe të kontrollohen basenet e trajtimit sedimentimit të vajrave dhe të bëhet zbrazja e tyre në vazhdimësi nga kompania e kontraktuar;
 - 2.3. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit të mjedisit që është përgjegjës për mjedis;
 - 2.4. Të kontrollohen në vazhdim kolektorët për grumbullimin e ujërave atmosferikë nga sipërfaqja e grumbullimit të mbetjeve të metali;

Faqe 2 nga 4



2.4. Të kontrollohen në vazhdim kolektorët për grumbullimin e ujërave atmosferikë nga sipërfaqja e grumbullimit të mbetjeve të metalit;

2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "Gratis Commerce" Sh.p.k., për veprimtarinë: Qendër grumbulluese e metaleve mbeturinë, Mitrovicë në ngastren nr.P- 71208072-02670-1 zona kadastarle, Mitrovicë, është konstatuar se plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 14/6127/2-ZSP/164/15, të lëshuar me datë : 24.08.2015;
- Pëlqim nga Komuna e Mitrovicës, me nr.prot.05-361/02.0033426/24 të datës: 17.05.2024.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Afrim Murati

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Mitrovicë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së